



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME PLENARE TË KUVENDIT
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 3 TETOR 2013**

**SA VANREDNE PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE
KOSOVA, ODRŽANE 3. OKTOBRA 2013. GODINE**

**TETOR - OKTOBAR
2013**

Rend dite

1. Formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me procesin e privatizimit të 75% të aksioneve të PTK-së.

Dnevni red

1. Formiranje Parlamentarne Anketne komisije o procesu privatizacije 75% udela PTK-a.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar zëvendëskryeministër,
I hap punimet e mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes” dhe të deputetëve të tjerë nënshkrues.

Të pranishëm janë 57 deputetë, por prania elektronike është 51. Ata që i kanë kartelat, le t’i vendosin. Ata që s’i kanë, le të paraqiten.

Pika e parë dhe e vetme e rendit të ditës:

1. Formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me procesin e privatizimit të 75% të aksioneve të Postë-Telekomit të Kosovës

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike dhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, të mbështetur edhe nga deputetët tjerë, gjithsej 40 deputetë nënshkrues, në bazë të nenit 77, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 4, pika 3 e Ligjit për hetim parlamentar, nenit 69, pika 2, dhe nenit 71, pika 1 të Rregullores së Kuvendit, kanë kërkuar formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me procesin e privatizimit të 75% të aksioneve të Postë-Telekomit të Kosovës.

Unë po e lexoj nenin 77 të Kushtetutës, pikën 2, dhe nenin 4 të Ligjit hetimor parlamentar.

Neni 77, pika 2 e Kushtetutës shkruan: “Kuvendi, me kërkesën e një të tretës së të gjithë deputetëve të tij cakton komisione për një çështje të veçantë, duke përfshirë edhe çështje hetimore”.

Neni 4, pika 3 e Ligjit thotë: “Në rastet kur kërkesa për themelimin e komisionit parashtrohet nga 1/3-ta e deputetëve, Kuvendi detyrimisht në seancë plenare e themelon komisionin për çështjen e kërkuar.

Pra, Kushtetuta, edhe ligji e thonë këtë që unë e lexova. Por, duhet të shtoj edhe diçka. Këtë pikën e Kushtetutës, kur është hartuar Kushtetuta e kam propozuar unë, pasi kam qenë anëtar i Komisionit për hartimin e Kushtetutës.

Në kohën kur kemi qenë në opozitë 2004-2007, unë si kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike e kam pas kërkuar një çështje për formimin e komisionit hetimor. Por, atëherë ka qenë e pamundur të krijohet komision hetimor, pa shumicën parlamentare. Për t’i ikur kësaj shumice, ne kemi kërkuar që me 1/3-ën e deputetëve të Kuvendit të formohet komisioni hetimor. Kjo është ecuria dhe për atë Kushtetuta shkruan decidivisht që 40 deputetë e kanë të drejtën e formimit të komisionit hetimor.

Mirëpo, Rregullorja e Kuvendit thotë se kryesuesin dhe anëtarët i zgjedh Kuvendi me shumicën e votave dhe këtu natyrisht që kemi një ndeshje ndërmjet asaj që shkruan

Kushtetuta dhe asaj që shkruan Rregullorja e Kuvendit. Pra, në raste të tilla Kushtetuta duhet ta ketë fuqinë më të madhe, edhe se ligji, edhe se Rregullorja e Kuvendit.

E ftoj përfaqësuesin e parashtruesit të mocionit që ta marrë fjalën. Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, zotin Ismet Beqiri.

Të pranishëm janë 59 deputetë.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ashtu siç e tha edhe kryetari i Parlamentit, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në nenin 77, pika 2, dhe bazuar në nenin 69, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 38 pika 2- C të Rregullores së Kuvendit, Grupi ynë Parlamentar, së bashku me Grupin Parlamentar të “Vetëvendosjes”, mbështetur edhe nga deputetë tjerë, kemi kërkuar mbajtjen e kësaj seance dhe konform kësaj Kryesia ka vendosur që sot ta kemi këtë seancë të jashtëzakonshme, me të vetmen pikë të rendit të ditës - Formimi i Komisionit Hetimor parlamentar lidhur me procesin e privatizimit të 75% të aksioneve të PTK-së.

Shkresën e keni, megjithatë, më lejoni të them që arsyetimi është ky.

- Duhet të hetohet baza ligjore e marrjes së vendimit për të nisur procesin e privatizimit të 75% të aksioneve të PTK-së;
- Duhet të bëhet hetimi i procedurave të ndjekura për procesin e tërësishëm të privatizimit, që nga shpallja e interesit deri te publikimi i kompanisë kinse më të mirë ofertuese, si dhe kërkesa për përmbylljen me miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës;

Privatizimi i 75% të aksioneve të PTK-së është një proces, i cili ka kaluar nëpër procedura jo të rregullta dhe besohet edhe për mundësi të mëdha manipulimi.

Grupi Parlamentar i LDK-së, i “Vetëvendosjes” dhe me përkrahje të deputetëve tjerë e ka kërkuar këtë seancë dhe ne po ashtu propozojmë që komisioni të ketë 11 anëtarë dhe të jetë përfaqësimi ashtu siç e parasheh Rregullorja: nga Grupi Parlamentar i LDK-së 2 anëtarë, PDK 2 anëtarë, “Vetëvendosje” 1 anëtar, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës 1 anëtar, KKR 1 anëtar, SLS 1, Grupi “6+” 1 anëtar, grupi ZB 1 anëtar dhe 1 deputet pa grup parlamentar.

Sigurisht që ne, duke e respektuar Rregulloren, propozojmë që kryesuesi i këtij grupi të jetë jo nga grupi iniciues dhe jo nga deputetët nënshkrues, ashtu siç parashihet, por një deputet që kur të vijë koha unë do ta them edhe propozimin që e kemi. Dhe, më lejoni të përsëris edhe atë se cili është mandati i këtij komisioni. Të jetë ajo që u tha edhe në arsyetim - hetimi i bazës ligjore të marrjes së vendimit për ta nisur këtë proces të privatizimit për 75% të aksioneve të PTK-së, të bëhet hetimi i procedurave të ndjekura për procesin e tërësishëm të privatizimit, që nga shpallja e interesit deri te publikimi i kompanisë më të mirë ofertuese, si dhe kërkesa për përmbylljen me miratim në Kuvend.

Privatizimi i 75% të aksioneve, edhe një herë e përsëris, lë hapësirë për të dyshuar, prandaj komisioni e ka edhe këtë obligim që ta hetojë këtë çështje. Dhe, komisioni të ketë mandat 6-mujor konform asaj që e parasheh edhe ligji.

Zoti kryetar,

Duke u mbështetur edhe në nenin që e thatë dhe në të gjithë e dimë, që çdo akt tjetër, nëse ka edhe kolizion, do të duhej t'i nënshtrohej Kushtetutës së Republikës së Kosovës si akti më i lartë i këtij vendi dhe në konsiderojmë që me 40 nënshkrime është baza e mjaftueshme ligjore që të formohet komisioni dhe, nëse më lejoni, unë do të bëja propozimin e anëtarëve, meqenëse jam këtu, nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe për kryesues të komisionit.

Në propozojmë që anëtarë të komisionit të jenë: Zonja Hykmete Bajrami, deputete, dhe zoti Armend Zemaj po ashtu deputet i Grupit Parlamentar të LDK-së dhe që anëtarit tjetër, meqenëse jemi iniciues, nga radhët e deputetëve, që nuk i takon një grupi parlamentar, të jetë profesor Muhamet Mustafa, të cilin njëkohësisht e propozojmë edhe kryesues të këtij komisioni.

Është e vërtetë që demokracia i lejon edhe këto bojkotime, por vërtet është e habitshme që pozita, më lejoni tash ta them në fund - pushteti, koalicioni qeverisës bojkoton, ose më mirë të them tenton ta sabotojë hetimin e një çështjeje që ne nuk e paragjykojmë, përpos bazës ligjore, që edhe sot e themi, e kështu do ta themi vazhdimisht, që s'ka pasur për t'u nisur ky privatizim, por mospjesëmarrja e tyre dëshmon edhe një herë paturpësinë, pafytyrësinë, edhe të deklarimeve se si janë për transparencë, për mbështetje të plotë të këtij procesi të hetimit, siç është thënë.

Por, le ta shohin qytetarët e Republikës së Kosovës, le ta vlerësojnë vetë dhe ne si grup parlamentar, si të gjithë iniciuesit e formimit të këtij komisioni, konsiderojmë, zoti kryetar, që mbështetur në Kushtetutë plotësohen të gjitha kushtet që ne ta formojmë atë dhe të tjerët mund t'i dërgojnë njerëzit e tyre në komision më vonë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti, kryetari i grupit të "Vetëvendosjes", deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës!

Të nderuar deputetë,

E thashë këtë herë për herë të parë 'të nderuar deputetë', sepse nuk janë ata të pandershmit.

Ajo çfarë e ka përshkruar këtë proces të privatizimit të PTK-së, si në fazën e parë, si në fazën e dytë, dhe tash në fazën e tretë të tij, është shumë lehtë e karakterizuar me një fjalë të vetme. Pra, çfarë kemi parë të ndodhë me këtë proces privatizimi është një puç qeveritar, një tentim puçi qeveritar. Sepse, mënyra se si është proceduar me procesin e privatizimit, pa e pasur asnjëherë vendimin e plotfuqishëm të Kuvendit për të vazhduar me një proces të tillë, nuk mund të konsiderohet ndryshe, përveçse shkelje dhe anulim i funksionit ekzekutiv dhe ekskluziv të Kuvendit karshi ndërmarrjeve publike në Kosovë.

Pra, Ligji për ndërmarrjet publike shumë mirë e përcakton që Kuvendi është ai i cili e merr vendimin për privatizimin e një pjese, apo në tërësi të një ndërmarrjeje publike. Dhe, kjo është logjika e cila sanksionohet me këtë ligj dhe e cila thotë, që në fakt ndërmarrjet publike janë në pronësi të publikut, ndërkohë që Qeveria me këtë ligj është si njëjloj administratori në besim i aksioneve të këtyre ndërmarrjeve. Dhe, natyrisht që administratori në besim nuk ka të drejtë të vendosë për shitjen e tyre, mirëpo për këtë duhet pyetur publiku. Dhe, në demokracitë parlamentare, natyrisht që Kuvendi është ai i cili konsiderohet të jetë institucioni përfaqësues i publikut, e jo Qeveria. Qeveria është ekzekutivi. Dhe, Qeveria me procedimin e këtij procesi të privatizimit, pa e marrë një herë miratimin e Kuvendit, e ka bërë pra këtë puç qeveritar, duke anuluar Kuvendin, përfaqësuesin e publikut, dhe duke marrë vendime krye më vete për pronën publike, për ndërmarrjet publike.

Dhe, tash kjo mungesë e deputetëve të koalicionit qeverisës, shumicës, dhe dalja së fundi e disa prej tyre që kishin gabuar e kishin ardhur në seancë pa i pyetur shefat e tyre, tregon që në fakt këta puçistë duan ta vazhdojnë puçin e tyre, pra duan ta pamundësojnë që Kuvendi të marrë vendime për ta mbrojtur ndërmarrjen publike të Kosovës, për ta mbrojtur Kosovën nga kjo Qeveri puçiste dhe gllabëruese.

Ky është hetimi i parë që duhet ta bëjë ky komision hetimor, pra duhet ta vlerësojë bazën ligjore dhe shkeljen eventuale të procedurave ligjore, që i përcaktojnë ligjet pozitive në Kosovë sa i përket privatizimit të ndërmarrjeve publike.

Çështja e dytë për të cilën foli edhe kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, janë dyshimet e mëdha për manipulim të procesit. Pra, kush e ka ndjekur procesin me vëmendje, e ka vërejtur që në të, në fund, kemi përfunduar me dy kompani, të cilat kanë ofertuar për blerjen e 75% të aksionit të Telekomit, ndërkohë që vetëm njëra në historikun e zhvillimit të procesit të parakualifikimit, kualifikimit dhe pastaj tenderimit, vetëm njëra prej tyre, pra vetëm AXOS-i, ka qenë e pranishme në secilën ngjarje që e ka organizuar Qeveria e Kosovës.

Ndërkohë që ‘Meni - International’ nuk ka qenë e pranishme në asnjë ngjarje të tillë, madje-madje nuk kanë pasur kurrfarë interesimi që të vijnë dhe të marrin informata shtesë për kompaninë, të cilën ka pretenduar ta blejë.

Kjo lë të dyshohet, edhe në dyshim të bazuar, që në fakt ‘Meni - International’ ka shërbyer vetëm si një kompani për ta përmbushur kushtin formal minimal të pranisë së dy kompanive në një proces tenderimi për shkak se ky vërtet është proces njëburimor i tenderimit, sepse ‘Meni - International’ asnjëherë nuk ka qenë i interesuar të dijë më shumë për procesin e privatizimit dhe për kompaninë të cilën pretendon se do ta blejë. Madje-madje, as në dy konferencat që i ka organizuar Qeveria e Kosovës, në maj të vitit 2012, nuk kanë marrë pjesë përfaqësuesit e ‘Meni - International’. Këtë e thotë edhe këshilltari i transaksionit në një prezantim të vijueshmërisë së procesit të privatizimit që ia ka paraqitur Komisionit për Zhvillim Ekonomik gjatë këtij viti.

Pra, ‘Meni - International’ ka ofertuar vetëm e vetëm për t’ia mundësuar AXOS -it që të vazhdojë tutje me procesin e privatizimit.

Dhe, ku shihet dallimi në ofertë, pra dallimi në çmim, që është shumë i lartë, është 127 milionë, 150 milionë i ka ofertuar 'Meni - International', 277 AXOS-i, aty vërehet që në fakt këto dy kompani nuk flasin për kompaninë e njëjtë. Pra, njëra është më shumë e informuar dhe ka më shumë detaje për kompaninë, ndërsa tjetra vetëm ka ofertuar një çmim sa për të thënë. Është e njëjtë me shumë procese të privatizimit të pronës shoqërore, të cilat kanë dalë të jetë të kurdisura dhe në të cilat i është lënë mundësia atij që është i interesuar të blejë që të ofertojë me një çmim të ulët, ndërkohë që ofertat tjera kanë qenë të papërfillshme.

Dhe, çështja e tretë që duhet të hetohet domosdoshmërisht është vetë AXOS-i. Pra, ende nuk kemi marrë asnjë përgjigje nga Qeveria e Republikës së Kosovës se kush është kjo kompani, prej nga do t'i marrë paratë, kush do të investojë nëpërmjet këtij fondi investues, sepse edhe ata e kanë pranuar në fund që është fond investues, pra nuk është kompani, çfarë mbështetje teknike do të kenë, çfarë roli do të ketë Telekom i britanik, çfarë roli do të ketë Telekom i Italisë, që u paraqit së fundi si njëri prej bashkëpjesëmarrësve në këtë proces të privatizimit, e kështu me radhë?

Pra, këto janë pyetje, të cilat domosdoshmërisht duhet t'i jepen Komisionit Hetimor nga Qeveria e Kosovës për shkak se AXOS-i është një kompani, e cila nuk figuron askund të jetë kompani ose fond investiv serioz, e veçanërisht jo fond investiv, i cili është marrë me investime në Telekom.

Për atë që kemi mundur të mbledhim informata nëpërmjet informatave publike, për këtë kompani është dëgjuar vetëm për dështimet e tyre në proceset e privatizimit të telekomit gjithandej nëpër botë dhe në rajon. Pra, asnjëherë nuk kemi një projekt serioz, të cilin AXOS-i e ka ndërmarrë dhe e ka dërguar deri në fund si fond investiv.

Po ashtu, lë shumë për të dyshuar edhe prania, ose pranimi publik që ia ka bërë drejtori ekzekutiv në gazetën "Jeta në Kosovë", ku thotë që fondet për blerjen e Postë-Telekomit të Kosovës do t'i marrin nga ishujt Kemen, pra nga një parajsë tatimore, dhe nga një llogari e tyre aty, që nuk dihet në fakt se kush do t'i japë këto para.

Po ashtu, ministri ka thënë që Banka Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim e ka vlerësuar procesin e privatizimit dhe e ka vlerësuar kërkesën e AXOS-it për ta financuar një pjesë të privatizimit të PTK-së, mirëpo në një vlerësim të tillë nuk e kemi parë kurrë, as si deputetë, e as si publik në Kosovë. Rrjedhimisht, nuk dihet se çfarë ka thënë Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për këtë proces të privatizimit. Pra, edhe kjo është një çështje e cila duhet të hetohet dhe po ashtu duhet të hetohet edhe plotësimi minimal i kritereve, të cilat kanë qenë në procesin e parakualifikimit, kur është kërkuar nga kompania që të dëshmojë se mund t'i mbledhë 250 milionë euro për të marrë pjesë në këtë proces të privatizimit.

Dhe, aty është thënë që ata me ofertën e tyre duhet të dorëzojnë edhe dokumente që e mbështetin këtë mundësi të tyre, po në fakt në këto nuk i kemi parë kurrë si deputetë ato dokumente.

Pra, nuk e dimë nëse AXOS-i vërtet e ka dorëzuar një zotim të tillë dhe aq më tepër tash po del që nuk po dihet nëse AXOS-i vërtet ka arritur t'i mbledhë këto 250 milionë euro për të marrë pjesë në procesin e privatizimit.

Pra, ka shumë çështje që duhet t'i hetojë ky komision, që janë shumë të rëndësishme, dhe kjo mungesë totale e përfaqësuesve të Qeverisë, edhe të përfaqësuesve të partisë në pushtet në Kuvend sot, tregon që këta në fakt e dinë që këto që po i themi ne janë të vërteta, prandaj edhe duan t'i fshehin.

Pra, duan ta fshehin të vërtetën prapa AXOS-it dhe prapa procesit të privatizimit, sepse e dinë që ky është proces i korruptuar, është proces i manipuluar, e dinë që në fakt kanë qenë pjesë të një puçi qeveritar, i cili është i jashtëligjshëm. Faleminderit!

KRYETARI: I nderuar deputet,

Është mirë që t'i kurseheni nga fjalët "i ndershmë" dhe "i pandershmë", se vërtet ne nuk jemi këtu ta matim ndershmërinë dhe pandershmërinë e askujt. Do të thotë, të ruhem i nga fjalët joparlamentare kur i themi, sidomos për ata që nuk janë të pranishëm.

Fjalën e ka kryetari i Grupit të Aleancës, deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës, ju që jeni këtu!

Situatën e kemi kësisoj, dy grupe parlamentare kanë vendosur t'i mbledhin nënshkrimet e domosdoshme, të nevojshme, dhe ta krijojnë një komision parlamentar, dhe e kanë bërë një gjë të tillë. Është krejt konform ligjit, krejt konform Kushtetutës dhe është e drejtë e plotë e grupeve parlamentare që ta bëjnë një gjë të tillë.

Pra, mendoj se pavarësisht se si mund të transmetohet, është goxha sjellje, po rifrazoj, zoti kryetar, jodemokratike, jo konform asaj çka po duam të ndërtojmë, që partitë në pushtet ta lëshojnë sallën.

Mendoj se sikur të kishin qenë këtu, kanë mundur ndoshta edhe të votojnë kundër krijimit të këtij komisioni, edhe pse krijohet me ligj, prapëseprapë nuk mund ta ndalin, është e drejtë kushtetuese.

Mendoj, po shihet që rruga në të cilën ka hyrë Kuvendi i Kosovës dhe politika e Kosovës është goxha problematike dhe nuk e di si do të përfundojë. Një ditë do të përfundojë, por si do të presim dhe do të shohim, se kjo situatë e bojkotimit të seancave të Kuvendit është goxha problematike.

Procesi i privatizimit është përcjellë me shumë parregullsi, e kemi të qartë. Unë mendoj se ky komision hetimor duhet të shkojë pak edhe më tutje, duhet të kthehet edhe më herët, se vetëm rasti i fundit i privatizimit, për shkak se proceset e mëhershme kanë qenë edhe më problematike se rasti i fundit i AXOS-it. Proceset e mëparshme kanë pasur situata në të cilat persona fizikë kanë negociuar në emër të Qeverisë së Kosovës për privatizim, që është tepër problematike.

Mendoj se ky komision duhet të kërkojë edhe raporte zyrtare nga institucione, të cilat janë marrë me privatizim në Kosovë dhe nga ministritë relevante dhe gjetjet e veta t'i krahasojë me raportet të cilat i sjell Qeveria për shkak se në atë mënyrë do të mund të vendoset edhe përgjegjësia - kush po sjell raporte edhe kush nuk po sjell raporte.

Është me të vërtetë ndjenjë e keqe. Unë mendoj se vazhdimi i këtillë i punës së Kuvendit është goxha problematik. Demokracia nuk ruhet prej diçkaje hyjnore, demokracia ruhet prej njerëzve të zgjedhur, e secili njeri që është zgjedhur e ka një përgjegjësi për ta ruajtur pak, me të mirat dhe me të këqijat e veta. Nëse kushdo për çfarëdo interesi e dëmton vazhdimisht në rrugë, nuk ka kush të na e ruajë demokracinë. Nëse dikush është për ta ruajtur demokracinë, ata janë deputetët e Kuvendit të Kosovës, është lidhshipi politik. Nëse gjysma e lidhshitit heq dorë, herë njëra palë, herë pala tjetër prej ruajtjes të kësaj çka është, mendoj se nuk mund të ruhet kështu. Dhe, askush tjetër, edhe një herë po ju them, nuk mund të na ruajë nëse nuk e ruajmë vetë.

Në fund, e kam një pyetje, shpresoj se Kuvendi i Kosovës nuk ka nevojë të marrë vendim, i cili mund të kontestohet, e nisja e seancës duhet t'i ketë 61 deputetë, por shpresoj që janë bërë tash dhe duhet të korrigjohet kjo nisje.

Dhe, çështja e fundit, në fakt, për të cilën duhet të flas se jam thirrur, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka caktuar deputetin Burim Ramadanin që të marrë pjesë në Komisionin Hetimor për Postë-Telekomin. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Pa dyshim që ne në seancën e kaluar i kemi kryer diskutimet në lidhje me atë se çfarë ka ndodhur me privatizimin e PTK-së, por një gjë që desha ta theksoj është kjo - arsyeja se pse Qeveria, pasi e ka kryer krejt punën, e ka sjellë për vendim në Kuvend, ndërkohë që të gjitha vendimet e tjera i ka marrë pa miratimin e Kuvendit.

Mendoj që kjo bëhet për një arsye - që grupi i ministrave të cilët kanë marrë pjesë në këtë privatizim, e bëjnë këtë, e sjellin pra vendimin final për ta marrë në Kuvend për një arsye - në mënyrë që t'i shmangen përgjegjësisë penale, e cila do të mund t'i kapte më vonë. Me një fjalë ata ta kryejnë punën, por fajin t'ia hedhin Kuvendit.

Së dyti, braktisja e sallës nga Partia Demokratike, pra nga pozita, dhe vetë logjika e bojkotit është në kundërshtim të plotë me funksionimin e institucioneve. Sipas kësaj logjike, ky Parlament mund të mblidhet vetëm kur i pëlqen pozitës dhe ky është deformim shumë i madh i logjikës demokratike dhe, natyrisht, çon vetëm në një rrugë qorre.

Së treti, një vërejtje shumë miqësore kryetarit të Grupit Parlamentar të LDK-së. Kjo iniciativë është nënshkruar nga deputetët e LDK-së, të "Vetëvendosjes" dhe deputetë të tjerë, të cilët kanë emra, zoti Beqiri. Kështu që ne jemi emra dhe jo numra, nga Alma Lama, nga Emin Gërbeshi dhe nga zoti Jakup Krasniqi. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, Ismet, replikë!

ISMET BEQIRI: Jo, jo replikë. Unë kërkoj ndjesë, domethënë nuk e kam bërë me qëllim, sepse duke pasur parasysh se janë emrat dhe nënshkrimet, kam menduar që i dinë të gjithë. Prandaj nuk është bërë me qëllim dhe më vjen keq që s'i kam përmendur emrat, do të thotë as të tjerëve deputetë, dhe është e vërtetë, si Grup Parlamentar e kam thënë, dhe më vjen keq nëse është keqkuptuar, por është bërë pa asnjë qëllim të keq. Faleminderit!

KRYETARI: Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit!

Unë jam nga ata deputetë që ka punuar në çështjen e privatizimit dhe që ka lobuar fuqishëm për një privatizim transparent dhe efektiv edhe të ndërmarrjeve shoqërore, edhe të ndërmarrjeve publike. Bile ne kemi lobuar që nga viti 2002, që të ndodhë privatizimi.

Prandaj, është shumë me rëndësi që gjërat të thuhën qartë. Pjesa më e madhe e debatit këtu lidhur me privatizimin e PTK-së nuk ka të bëjë me dikë, a është dikush për apo kundër privatizimit. Dallimet tona janë lidhur me atë se a i duhet Kosovës një privatizim efektiv, transparent, i bazuar në ligj, i bazuar në interesin më të mirë publik dhe i bazuar në interesin më të mirë të investitorit? Këtu i kemi problemet.

Dhe, lidhur me këto probleme ne kemi debatuar gjatë në këtë Kuvend. Ne kemi theksuar se ky proces është në rrezik të komprometimit të tij për shkak se i mungon baza ligjore dhe për shkak se po përcillet me kontraverse dhe probleme të tërheqjes së investitorëve, problemet me një rund, me dy runde, me tri runde, të cilat e komprometojnë procesin. Kjo ka qenë frika jonë, për të cilën kemi diskutuar edhe në këtë Kuvend, edhe në opinion, nganjëherë në mënyrë bukur dramatike, e nganjëherë kemi thënë se jeni emotivë.

Natyrisht që shpeshherë për këto çështje jemi edhe emotivë, sepse kemi të bëjmë me demokracinë dhe me pasurinë publike dhe pasurinë që u takon të gjithë qytetarëve të Kosovës. Në këtë drejtim, unë dëshiroj pak ta përmend këtu se ne tash po ndodhemi në një problem, po dëgjohen tezat se më së miri është për ta privatizuar, sepse do të humbim. Ta privatizojmë qysh do të jetë, ligj e pa ligj, edhe ta privatizojmë duke e neglizhuar rolin e Kuvendit.

Mendoj se kjo është problematike, pak a shumë. Shumë problematike. Dikush duhet ta marrë përgjegjësinë, natyrisht. Përgjegjësinë duhet ta marrin ata që eventualisht e kanë udhëhequr këtë proces jashtë procedurave ligjore, si të të them e kanë komprometuar në një masë, gjë që do të shihet, ose ata - opozita dhe një pjesë e deputetëve tjerë, të cilët po e pengojnë gjoja privatizimin e PTK-së.

Dëmi shoqëror veç është krijuar. Ne kemi filluar me privatizimin, me iniciativën më 2009. Sot është 2013. Për katër vjet, çdo qeveri e suksesshme do t'i gjente bazat ligjore, mënyrat më të mira, më efektive, në interesin më të mirë publik, në interesin më të mirë të investitorit që ta bëjë privatizimin.

Puna e parë që duhet të bëjë kjo Qeveri është se duhet të vijë në Kuvend dhe të thotë pse për katër vjet s'ka arritur ta privatizojë. Sa vjet duhen që ta privatizojë këtë? Çka ka

ndodhur për këto katër vjet? Dëmi është krijuar, sepse vlера që e shesim ne sot, edhe në qoftë se është krejt me ligj dhe e shesim, 240 e diçka milionë është një vlerë që ndoshta e imponon tregu, dhe unë nuk kam hyrë t'i vlerësoj ato, por është një vlerë, sipas të gjitha kriterëve, e ulët. Neve na duket e ulët kjo. Po të kishte qenë privatizimi transparent, privatizim i rregullt me një konsensus bazik shoqëror, pa probleme politike, sigurisht se do të shitej më mirë.

Por, të mos e zgjasim më tej, prandaj mund të jetë që herën tjetër, mund të jetë - mund të ndodhë, edhe në qoftë se procesi zhvillohet me ligj, eventualisht ne të kemi ofertë më të ulët se 240 milionë. Nuk e përjashtoj atë mundësi, por ata që thonë se do të ulet, ky është paragjykim. Ndoshta është edhe tentim që edhe më tepër t'ia ulim lerën. Ky është paragjykim. Sa do të jetë vlера, do ta tregojë një proces transparent i ardhshëm. A do t'i bjerë, apo nuk do t'i bjerë vlера, do ta tregojë e ardhmja.

Prandaj, të mos manipulojmë me këtë. Roli ynë këtu është që ta kthejmë procesin në binarë ligjorë, që ta demonstrojmë gatishmërinë politike, edhe të Qeverisë, edhe pozitës, edhe të opozitës, që gjërat të shkojnë sipas ligjit, dhe sipas interesit më të mirë publik dhe interesit më të mirë të investitorit. Unë besoj se në këtë çështje mund të krijojmë një konsensus bazik. Besoj që edhe pozita do t'i kthehet kësaj çështjeje me një rezon më të përgjegjshëm dhe që do ta kryejmë procesin e privatizimit në mënyrën ligjore.

Sa më përket mua personalisht, unë t'jua them të drejtën, e falënderoj LDK-në që ka propozuar që unë të jem dhe ta udhëheq komisionin. Dhe, unë, e dini, e kam udhëhequr para pak kohe një komision tjetër. Kemi bashkëpunuar mirë dhe kemi arritur ta bëjmë një konsensus ndërmjet opozitës dhe pozitës në komision dhe unë kam menduar ta pranoj apo jo, sepse veçsa ka përfunduar ai komisioni paraprak, por e kam pranuar vetëm për faktin se jam i interesuar që të kontribuoj që me të vërtetë këtij Kuvendi t'i kthehet roli që duhet ta ketë dhe procesit të privatizimit të PTK-së t'ia japim legjitimitetin, ta sjellim në binarët legalë dhe ta privatizojmë në interesin më të mirë publik dhe në interesin më të mirë të investitorit.

Po e shihni, unë katër herë e përsërita këtë frazë, sepse vetëm kjo është ajo që na çon në rrugë të mirë dhe në zhvillim ekonomik, duke e respektuar interesin më të mirë publik dhe interesin e investitorit, po e përsëris për të pastën herë. Faleminderit!

KRYETARI: Zëvendëskryeministri Bukoshi e ka fjalën.

ZËVENDESKRYEMINISTRI BUJAR BUKOSHI: Faleminderit, zoti kryetar!

Deputetë të nderuar,

Unë me këtë rast e kam vetëm një fjalë të shkurtër. Duke u nisur prej disa postulateve elementare, dje e kam marrë ftesën nga Parlamenti i Kosovës që të marrë pjesë në seancë, si zakonisht.

E dyta, unë mendoj që vetë fjala Parlament e ka origjinën prej parlae - 'me folë'. Mund të flitet për gjithçka. Por, ajo çka mua më shqetësoi pak, jo privatisht, por drejtimi i deputetit të "Vetëvendosjes", zotit Ymeri, me do pretendime, që thotë kush është i ndershëm, kush është i pandershëm.

Zoti Ymeri, ju e dini, unë më së pari me profesion jam urolog dhe merrem me disa organe të urologjisë. I njoh menjëherë, s'i t'i shoh, nën një.

E dyta, kisha dëshiruar që në të ardhmen të ruhet niveli i këtij Parlamenti. Unë e respektoj shumë Parlamentin e Kosovës, se është instanca më e lartë. Për tjerat, janë sfera tjera, për të cilat unë nuk dua të acaroj, por vokabulari, fjalori, sjellja dhe disa insinuata nuk janë mirë edhe për subjektin tuaj, në të cilin merrni pjesë. Faleminderit!

KRYETARI: “Vetëvendosje”, nuk e keni propozuar anëtarin për komision. Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Po, kryetar, faleminderit, se harrova ta propozoj. Për “Vetëvendosjen” do të jem unë, pra Visar Ymeri, si anëtar i komisionit.

KRYETARI: Faleminderit! Unë e kisha lexuar nenin 6 të Ligjit - Detyrimet e organeve të Kuvendit. Dhe, po e lexoj krejt, janë katër pika, për të qenë korrekt edhe me vetveten, edhe me opinionin.

1. Kryetari i Kuvendit, jo më vonë se 7 ditë nga dita e marrjes së kërkesës për ngritjen e komisionit, e thërret Kryesinë e Kuvendit për ta diskutuar nismën, por kjo nismë ishte bërë edhe me thirrjen e seancës së jashtëzakonshme;

2. Pavarësisht nga propozimi i nismëtarëve lidhur me numrin e anëtarëve të komisionit, Kryesia e Kuvendit, para themelimit të komisionit, mund t'i propozojë Kuvendit zgjerimin ose zvogëlimin e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të komisionit;

3. Kryesia ia propozon Kuvendit përbërjen e komisionit, në bazë të nominimeve të grupeve parlamentare për anëtarë të komisionit. Në rast se një grup parlamentar nuk i përgjigjet kërkesës së Kryesisë me kohë, Kryesia i propozon Kuvendit përbërjen nga nominimet e bëra nga grupet parlamentare dhe pozitat e panominuara mbeten të zbrazëta.

4. Kryesia e Kuvendit e radhit kërkesën për ngritjen e komisionit në rend të ditës jo më vonë se 3 javë kalendarike, pas datës së paraqitjes së kërkesës nga propozuesi. Në rast se Kryesia nuk arrin ta radhisë kërkesën në afatin e lartpërmendur, kërkesa e iniciuesit shqyrtohet, pa propozimin e Kryesisë, në mbledhjen e parë të radhës së Kuvendit.

Kjo thuhet në ligj. Atë që e shkruan Kushtetuta, e thamë më herët. Tani jemi këtu ku jemi dhe për të votuar, por s'mund të votojmë, sepse s'e kemi numrin e duhur të deputetëve, ngase të pranishëm janë diku rreth 53 deputetë.

Pra, kjo është e tëra. Të lajmëruar për debat nuk kemi, prandaj e presim plotësimin e komisionit në seancën e radhës. Mirupafshim!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*